



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:223927

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06695243

KPPP.nr. 1245/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Toni Commerce” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810198996 dhe seli në Prishtinë, Zona Industriale, Tregu i Gjelbër, kundër debitorit “S.N” B.I., me emër tregtar “M.N”, me numër unik identifikues ... dhe seli në Obiliq, ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 439/24 i datës 26.04.2024, të lejuar nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 10.01.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “S.N” B.I., me emër tregtar “M.N”, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 439/24 i datës 26.04.2024, i lejuar nga Përbaruesi Privat Destan Bujupaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Toni Commerce” Sh.P.K., me datë 26.04.2024, ka lëshuar urdhrin P.nr. 439/24, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumenteve të besueshme: Faturës nr. 186-210-001-21 e datës 11.11.2021; Faturës nr. 175-210-001-21 e datës 12.10.2021; Faturës nr. 168-210-001-21 e datës 30.09.2021 dhe Faturës nr. 157-210-001-21 e datës 24.09.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “S.N” B.I., me emër tregtar “M.N”, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,921.40 EUR (*dy mijë e nëntëqind e njëzet e një euro e katër dhjetë cent*), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbarimor, me arsyetimin se urdhri përmbarimor nuk i përmbush kushtet e parapara me nenin 21 dhe 29 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor nuk janë pranuar nga debitori në asnjërën nga format e parapara me ligj, pra të njëjtat nuk përmbajnë vulën e pranimit të debitorit, andaj nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme. Duke qenë se urdhri përmbarimor është nxjerrë në kundërshtim me nenin 71, pika 1.1 dhe 1.7 të LPP-së, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që të paguajë shpenzimet e procedurës për përpilimin e prapësimin në shumë prej 156.00 EUR.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit pasi që qëllimi i tij është shtyerja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit. Ka shtuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor janë në origjinal, janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, duke plotësuar të gjitha kushtet sipas nenit 27 dhe nenit 29, par. 3 të LPP-së dhe si të tilla janë të përshtatshme për përmbarim. Më tej, ka theksuar se debitori pretendimet e paraqitura në prapësim nuk i ka mbështetur me prova, siç përcaktohet me nenin 69, par. 4 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se dokumentet: Fatura nr. 186-210-001-21 e datës 11.11.2021; Fatura nr. 175-210-001-21 e datës 12.10.2021; Fatura nr. 168-210-001-21 e datës 30.09.2021 dhe Fatura nr. 157-210-001-21 e datës 24.09.2021, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata po ashtu gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në fatura, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përbarimit pasi që janë të përshtatshme për përbarim.

Në vlerësimin e pretendimeve të debitorit të ngritura me prapësim, gjykata gjeti se nuk provohet ekzistimi i asnjë prej shkaqeve taksative të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit, është vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1245/24, datë 10.01.2025

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.